



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K1/I7-3 Prot.**  
**Nr. Dok. 202300153/3**

**Tiranë 21.12.2023**

**Lënda:** *Rekomandim për vlerësimin e mundësive për ngritjen e një programi studimi të nivelit të dytë në gjuhët shipe dhe rome, pranë Departamentit të Gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit, si program formimi vazhdues i programit të nivelit të parë, si dhe kryerjen e një analize dhe vlerësimi të mundësive për hapjen e programeve të studimit, fillimisht të nivelit të parë, e më pas edhe të niveleve të tjera, edhe në universitetet e tjera publike në vend.*

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

Të nderuar,

Avokati i Popullit, në vijim të ushtrimit të misionit kushtetues, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut e konsidron mbrojtjen e garantimin e të drejtave të minoritetit kombëtar Rom si një ndër prioritetet e domosdoshme për progresin e mëtejshëm të integritimit në BE të vendit tonë. Pasi jemi njohur me rekomandimet e grupeve të interesit lidhur me ofrimin e mësimin të gjuhës rome, mbështetjen për hapjen dhe zhvillimin e klasave të gjuhës rome nga "instrukturë" të gjuhës rome, dhe ngritjen e një programi studimi për aftësimin e mësuesve të gjuhës rome, të prezantura në dokumentin e politikave mbështetëse për kualifikimit dhe punësimin e mësuesve të gjuhës rome, kemi filluar ndjekien me iniciativë të çështjes së kualifikimit dhe punësimin të mësuesve të gjuhës rome, dhe për hapjen e këtyre degëve të studimit në disa universitete të tjera të vendit, në ato qytete në të cilat banon pakicë rome, si një iniciativë e cila nxit jo vetëm politika të arsimit por edhe politika të punësimin si një nga mënyrat me efikase për integrimin e anëtarëve të pakicës kombëtare rome në shoqëri.

Një nga të drejtat themelore, pjesë e katalogut të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, e garantuar në nenin 57, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është e drejta për arsimim<sup>1</sup>, e cila sanksionohet gjithashtu edhe në nenin 2, të Protokollit nr.1, të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>2</sup>. Gjykata Evropiane për të Drejtat e

<sup>1</sup> Neni 57 i Kushtetutës parashikon se: "1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj."

<sup>2</sup> Neni 2 i KEDNJ parashikon se: "Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike".

Njeriut në disa raste<sup>3</sup> ka adresuar vështirësitë që lidhen me arsimimin e fëmijëve romë, duke vënë theksin në vëmendjen dhe mbrojtjen e veçantë që u nevojitet atyre nga shteti, e cila përfshin dhe fushën e arsimimit.

Veçanërisht, në rastin e minoritetit Rom në Shqipëri, ushtrimi dhe respektimi i kësaj të drejte merr një rendësi të veçantë për të garantuar vijueshmërinë e traditave, kulturës dhe gjuhës së këtij komuniteti, por njëkohësisht edhe diversitetin shoqëror e integrimin e tyre në shoqëri. Në gjykimin e Avokatit të Popullit, arsimimi i pjesëtarëve të këtij minoriteti, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat me efikase për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Niveli i ulët arsimor është problem serioz, që pengon integrimin e këtij komuniteti në shoqëri. Sfidave ekonomike, sociale e kulturore me të cilat përballlet ky komunitet u shtohet edhe vështirësia e komunikimit në gjuhën rome dhe shqipe.

Ligji nr. 96/2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare e garanton të drejtën e arsimit për pakicat kombëtare, duke e njohur veçanërisht si të rëndësishme të drejtën e arsimit dhe marrjen e mësimave në gjuhën e pakicës<sup>4</sup>. Ky ligj siguron të drejtën e fëmijëve të pakicave kombëtare për të mësuar gjuhën e pakicës. Zbatimi i tij në praktikë kërkon përgatitjen dhe punësimin e mësuesve të kualifikuar për gjuhën e komunitetit rom. Përparimi i politikave për përgatitjen dhe punësimin e mësuesve të kualifikuar për gjuhën shqipe dhe rome do të siguronte të drejtën e fëmijëve rom për të mësuar gjuhën rome. Nga ana tjetër, mësimi i gjuhës rome në shkollë do të ishte një mjet tepër efektiv për të ndihmuar fëmijët romë në përballjen me sfidat e komunikimit. Mosmarrja masave të nevojshme në këtë drejtim rrit mungesën e aksesit të fëmijëve rom në arsimim dhe u mohon atyre të drejtën për të mësuar gjuhën e tyre të komunitetit.

Ruajtja e gjuhës rome përfaqëson një hap thelbësor në ruajtjen dhe nxitjen e identitetit kulturor të komunitetit rom. Kjo gjuhë nuk është thjesht një mjet komunikimi, por një pasuri e shoqëruar me histori, tradita dhe vlera të veçanta. Përmes gjuhës rome, trashëgimia kulturore dhe historike e tyre transmetohet nga brezi në brez. Ruajtja e kësaj gjuhe siguron mbajtjen e një dimensionit të plotë të identitetit rom, duke ndihmuar ata të mbajnë lidhjet me prejardhjen e tyre, të ndjehen të përfshirë në komunitet dhe të rrisin shanset për përparim social dhe ekonomik. Gjuha rome përfaqëson një mjet shumë të rëndësishëm për të ruajtur diversitetin kulturor dhe për të kultivuar respektin ndaj të drejtave themelore të njeriut. Investimi në ruajtjen dhe avancimin e kësaj gjuhe për këtë komunitet është thelbësor për të garantuar që pasuria e tyre kulturore të mbijetojë dhe të përshtatet në mënyrë të përshtatshme me kontekstin e kohës së sotme. Ky investim kontribuon në ruajtjen e trashëgimisë së tyre kulturore.

Sigurimi i ruajtjes dhe promovimit të gjuhës rome është shumë i rëndësishëm për të mbështetur pasurinë kulturore të komunitetit rom. Shteti duhet të ndërmarrë veprime të rëndësishme, jo vetëm në planin moral, por edhe në aspektin ligjor, për të mbrojtur, përkrahur dhe zhvilluar këtë gjuhë. Kjo përfshin krijimin e politikave dhe ligjeve që garantojnë të drejtat e komunitetit rom për të folur dhe ruajtur gjuhën e tyre tradicionale. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të sigurohet që të gjithë të kenë mundësinë për të marrë arsim dhe shërbime publike në gjuhën rome në mënyrë të barabartë. Investimi në programe të edukimit dhe trajnimit për mësuesit rom, si dhe zhvillimi i materialeve mësimore në këtë gjuhë, do të ndihmojë në përhapjen dhe fuqizimin e saj.

<sup>3</sup> Çështjet [D.H. e të tjerë kundër Republikës Çeke](#); [Sampanis e të tjerë kundër Greqisë](#); [Lavida e të tjerë kundër Greqisë](#), etj.

<sup>4</sup> Neni 13 pikat 1 e 2 të këtij ligji parashikojnë: 1. Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës. 2. Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht ose në numër thelbësor, nëse ka kërkesë të mjaftueshme, u sigurohen mundësi për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

Neni 13, pika 5 e këtij ligji parashikon marrjen e masave të përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, të cilat duhet të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përveç kësaj, mbështetja financiare për organizatat dhe projektet e komunitetit rom që punojnë në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës rome është gjithashtu thelbësore për të arritur këtë qëllim. Ky angazhim në të gjitha nivelet e shoqërisë është i nevojshëm për të siguruar që kjo gjuhë të ruhet dhe të përparojë në të ardhmen.

Humbja e gjuhës rome është një çështje që shqetëson në mënyrë të veçantë anëtarët e këtij komuniteti, shqetësime të cilat janë prezantuar edhe pranë institucionit tonë e po ndiqen me vëmendje për të vlerësuar të gjithë hapësirat e bashkëpunimit me organet përgjegjëse shtetërore. Një nga këto shqetësime, që prezantohet edhe në dokumentin e politikave mbështetëse për kualifikimin dhe punësimin e mësuesve të gjuhës rome<sup>5</sup> lidhet me zbatimin e politikave mbështetëse për studentët që kanë ndjekur programin "Bachelor" në gjuhët shqipe dhe rome pranë Departamentit të Gjuhësisë në Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan. Programi ka qenë ndërprerë gjatë dy viteve të fundit, duke penguar kualifikimin e mësuesve të gjuhës rome dhe mësimdhënien e gjuhës rome në shkolla, në përputhje me kërkesat ligjore. Në të njëjtën kohë, studimi thekson se mungon një program kualifikimi 'Master në gjuhët shqipe dhe rome' për të diplomuarit në shkencat sociale, humane dhe arte, të cilët kanë njohuri të gjuhës rome dhe dëshirojnë të specializohen si mësues të kësaj lënde. Përveç kësaj, mësimi i gjuhës rome në shkolla si pjesë e programit "*Shkolla Qendër Komunitare*" ka hasur vështirësi financiare dhe mungesë të financimit të qëndrueshëm. Situata kërkon marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar përfshirjen e studentëve që i përkasin pakicës rome në kategorinë e studentëve në nevojë, përjashtimin e tyre nga tarifa vjetore në të gjitha ciklet e studimeve universitare dhe aplikimin e bursës së plotë për këtë kategori, si dhe kategorizimin e 'programeve Bachelor dhe Master në gjuhët shqipe dhe rome' si fusha prioritare në vend.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se institucionet arsimore kanë një rol të veçantë në ruajtjen dhe sigurimin e vazhdimësisë së gjuhës rome, si nëpërmjet dhënies së mundësisë për arsim në këtë gjuhë, ashtu edhe për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm.

Hapja e programit të studimit "Bachelor" në gjuhët shqipe dhe rome pranë Departamentit të Gjuhësisë në Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan duhet të shërbejë si gur themeli për hapjen e programeve të tjera të studimit në këtë Universitet por edhe në universitetet e tjera të vendit, në ato qytete në të cilat banon pakicë rome, si një iniciativë e cila nxit jo vetëm politika të arsimimit por edhe politika të punësimit si një nga mënyrat me efikase për integrimin e anëtarëve të pakicës kombëtare rome në shoqëri. Këto politika nxitëse mund të përfshijnë ngritjen e një programi studimi të nivelit të dytë në Universitetin e Elbasanit, si vazhdim i programit të nivelit të parë Bachelor; hapjen e programeve të studimit, fillimisht të nivelit të parë, e më pas edhe të niveleve të tjera, edhe në universitetet e tjera publike në vend; ofrimin e mbështetjes financiare për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe shkollimit përgjatë gjithë cikleve të studimit; garantimin e punësimit në programe publike që synojnë përfshirjen në arsim të fëmijëve që u përkasin pakicës rome, përfshirë dhe programet e qendrave komunitare, programet e bashkive, etj.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e së drejtës për arsimimin në gjuhën e pakicës kombëtare dhe aksesit të vazhdueshëm e me prioritet të pjesëtarëve të minoritetit Rom në sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 1, të "Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut", në të cilët thuhet se: "*Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave*", në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës, të nenit 24/a, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar,

---

<sup>5</sup> Dokument Politikash: [POLITIKA MBËSHETËSE PËR KUALIFIKIMIN DHE PUNËSIMIN E MËSUESEVE TË GJUHËS ROME](#)

## **REKOMANDOJMË**

- *Vlerësimin e mundësive për ngritjen e një programi studimi të nivelit të dytë në gjuhët shipe dhe rome, pranë Departamentit të Gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit, si program formimi vazhdues i programit të nivelit të parë;*
- *Kryerjen e një analize dhe vlerësimi të mundësive për hapjen e programeve të studimit, fillimisht të nivelit të parë, e më pas edhe të niveleve të tjera, edhe në universitetet e tjera publike në vend.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se:

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,*

lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Vilma SHURDHA**